



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 17/08

Prishtinë, më 11.07.2008, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Müfera Şinik, Shkumbin Demaliaj dhe Hajdin Abazi.

Anëtarët jo të pranishëm: Besa Gaxherri, Behxhet Pacolli.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ali Hamiti, Xhyllhane Murtezi, Xhemile Beqiri, Nysret Avdiu - përfaqësues nga ZRRE-ja, Argjentina Grazhdani, Naile Krasniqi, Arben Divalli, Ganimete Nuaj - përfaqësues nga KPM-ja, monitorues nga OSCE, NDI.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 1 dhe 4 korrik 2008;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin 2007**
Të ftuar: Përfaqësuesit e bordit të ZRRE-së;
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për vitin 2007 me rekomandimin e komisionit funksional - Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media**

- Të ftuar: Përfaqësues nga KPM-ja;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit të detalizuar financiar të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për vitin 2007**
 - 6. Të ndryshme**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 1 dhe 4 korrik 2008

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi avancimin në hartimin e procesverbaleve në këtë legjislaturë, për dallim me ato të kaluarat dhe për këtë përgëzoi stafin mbështetës të Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e dt. 01 dhe 04 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin 2007 **Të ftuar: Përfaqësuesit e bordit të ZRRE-së**

Kryesuesi, hapi diskutimin për raportin e ZRRE-së për vitin 2007.

Armend Zemaj, theksoi se nuk ka vërejtje sa i përket mënyrës së hartimit të raportit. Megjithatë bëri një pyetje lidhur me tarifat, a kishte planifikuar ZRRE-ja që gjatë vitit 2007 të ketë rritje të këtyre taksave apo si qëndron situata këtë vit në këtë drejtim.

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të fokusohen vetëm në pjesën e pasqyrave financiare të raportit, për arsye se pjesa e përgjithshme është trajtuar nga komisioni funksional.

Ali Hamiti, shpjegoi se hartimi i raportit të ZRRE-së, është bërë konform dispozitave të ligjeve përkatëse dhe në të janë pasqyruar të dhënat financiare lidhur me të hyrat dhe shpenzimet që ka realizuar kjo zyrë. Në pyetjen e deputetit Zemaj, tha se taksat dhe të hyrat nga ato janë përcaktuar për tri vite dhe se detyrë e ZRRE-së është të rishikojë se a ka nevojë të bëhet nivelizimi i tyre. Z. Hamiti në vazhdim paraqiti një problem që po ballafaqohet ZRRE-ja. Sipas tij nga viti i kaluar janë bartur një shumë e konsiderueshme parash (€600.000), të cilat për shkak të pengesave ligjore nuk janë shfrytëzuar dhe në një situatë të tillë ZRRE-ja, është në një pozitë të vështirë se si t'i shfrytëzojë ato. Andaj në këtë kontekst kërkoi që edhe Komisioni të jap ndihën e tij, që të eliminohen këto pengesa ligjore në shfrytëzimin e parave suficitare, në të kundërtën do të duhet që këto mjete t'iu kthehen konsumatorëve, nga të cilët edhe janë arkëtuar ato.

Kryesuesi, vlerësoi raportin e ZRRE-ja si të përgatitur mirë, i cili përmban pikat kryesore që parasheh ligji. Megjithatë bëri disa vërejtje rreth përpilimit të raportit nga të gjithë Agjensionet e Pavarura. Kërkoi që ato raporte të jenë më analitike e jo të përgjithësuara siç kanë qenë deri më tani. Gjatë hartimit të raportit vjetorë por edhe periodike të respektohet Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në veçanti neni 46 i tij, ku parashihen të gjitha kushtet që duhet përmbaj një raport, në të kundërtën Komisioni në të ardhmen nuk do t'i shqyrtojë dhe do të i kthej prapa për plotësim, ashtu siç ka bërë edhe me raportin e RTK-së për vitin 2007. Në vazhdim pyeti se në kategorinë shpenzime tjera çfarë është nënkuptuar, cilat janë ato shpenzime.

Xhyllhane Murtezi, lidhur me pyetjen për shpenzimet tjera, theksoi se janë shpenzime që janë bërë nga zyrtarët në aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit, dhe janë definuar si të tilla për shkak të moskategorizimit të kodeve ekonomike për ato. Ndërsa lidhur me mjetet suficitare është njoftuar Thesari dhe Drejtoria e Buxhetit të MEF me kohë dhe ende nuk kemi ndonjë zgjidhje të këtij problemi.

Shkumbin Demaliaj, mbështeti raportin e komisionit funksional për raportin e ZRRE-së. Ndërsa bëri një pyetje, se a ka bazë ligjore për caktimin e taksave për licenca, kush e bënë lartësinë e tyre.

Ali Hamiti, në pyetjen e parafolësit, theksoi se Ligji për ZRRE ka përcaktuar të drejtën e Agjensionet për të caktuar taksa për licenca. Ndërsa lartësia e tyre është caktuar pas organizimit të një dëgjimi publik, me praninë e institucioneve relevante (Qeveria dhe Kuvendi), të licencuarve dhe pjesëmarrësve tjerë të interesuar.

Nysret Avdiu, duke u kyçur në diskutimet e parafolësve, tha se Ligji ka përcaktuar që mjetet suficitare nuk mund t'i kthehen qeverisë, por të njëjtat të barten në vitin pasues dhe ato shpenzohen për projektet që ka agjensioni dhe shërbimet tjera, përjashtimisht për paga.

Kryesuesi, u pajtua me vërejtjet për pengesat ligjore në shfrytëzimin dhe menaxhimin e parave publike. Këtë çështje komisioni e ka ngritur edhe në të kaluarën, që pjesa financiare e këtyre Agjensioneve të rregullohet me ligje të veçanta. Kërkoi nga agjensioni që të marrin iniciativën për të plotësuar nenin e ligjit ku parashihet pjesa financiare, në mënyrë që mos të paraqiten pengesa ligjore në shfrytëzimin e këtyre mjeteve nëse egzistojnë projektet konkrete. Një problematikë ekziston edhe në Agjensionet tjera andaj kërkon nevojën më të shpejtë për eliminimin e pengesave ligjore në shfrytëzimin dhe menaxhimin e parave publike.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Miratohet në parim Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007, dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis në rendin e ditës, për shqyrtim në seancën plenare.

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për vitin 2007 me rekomandimin e komisionit funksional -Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
Të ftuar: Përfaqësues nga KPM-ja

Kryesuesi, hapi diskutimin lidhur me pikën e katërt të rendit të ditës.

Argjentina Grazhdani, paraqiti një prezantim të shkurtër të strukturës dhe funksionimit të KPM-së. Në këtë kontekst, znj. Grazhdani u ankua për pagat e vogla që marrin të punësuarit, e që mesatarja e pagës është 250 € e që janë tetë herë më të vogla se në industrinë që i monitorojnë. Si rezultat i një situatë të këtyre financiare, KPM-ja ka humbur 11 punëtorë, madje shumica nga vendet kyçe. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka ky rregullator në monitorimin e operatorëve televiziv dhe kabllor, kërkoi që në të ardhmen të rregullohet çështja e kompensimit dhe akomodimit të punonjësve të këtij rregullatori.

Kryesuesi, lidhur me pjesën financiare të raportit, theksoi se në të nuk janë paraqitur të hyrat vetanake, po ashtu nuk janë paraqitur donacionet siq e parasheh Ligji për raportim, përveç granteteve të qeverisë. Gjithashtu pyeti se sa janë të hyrat nga licencat, të cilat nuk figurojnë në raport.

Armend Zemaj, pyeti pse nuk janë pasqyruar në raport të hyrat nga licenca e operatorëve kabllor, kur dihet fakti se është vendosur se deri në muajin qershor të gjithë këta operatorë duhet licencuar. Po ashtu vërejtje bëri për mospërcaktimin, se ku do të derdhen mjetet e arkëtuara nga taksat.

Haki Shatri, u pajtua me problemet financiare dhe buxhetin modest që ka ky agjension, si rezultat i të cilave edhe mund të paraqiten probleme në punën e suksesshme të këtij agjensioni. Në vazhdim pyeti se kur është afati i fundit për licencimin e operatorëve kabllor dhe se a keni planifikuar që këto mjete të inkasuara nga licenca të përshihen si të hyra dhe shpenzime në buxhetin e viti 2009. Z. Shatri bëri një vërejtje rreth artikujve që shkruajnë gazetatat duke mos respektuar kodin e etikës dhe kërkoi që ky agjension të bëjë monitorimin e tyre më të plotë. Në fund kërkoi që KPM-ja të jetë më rigoroz ndaj operatorëve duke kërkuar nga ata që të kryejnë obligimet konform afateve që parasheh ligji.

Shkumbin Demaliaj, lidhur me diskutimet, theksoi se forma se si i qasen këtij raporti i ngjan debatit të një raporti financiar të një OJQ-je. Më tutje vazhdoi se pasqyra buxhetore nuk është e detalizuar. Po ashtu vërejtje bëri lidhur me dhënien e licencave të cilët favorizohen disa rajone. Kritikoi për tërheqjen e licencës së RTV të Mitrovicës. Po ashtu pyeti se sa respektohet ligji me rastin e shqiptimit të gjobave të operatorëve. Duke parë një numër të madh të parregullsive z. Demaliaj propozoi që raporti të shtyhet për plotësim ose përndryshe do të votojë kundër miratimit të tij.

Myrvete Pantina, lidhur me afatin e zgjidhjeve të rasteve kontestuese, nga raporti 2007 shifet se ai është zgjatur më tepër se sa e parasheh ligji, gjë që tregon një mosrespektim të afateve procedurale ligjore (përmendi rastin e TV Men, ndaj të cilit është shqiptuar gjoba 500 € ndërsa procedura e ekzekutimit është zgjatur), andaj pyeti se përse ndodh kjo dhe a ka kufizim përfundimtar të afatit kur duhet të zgjidhet kontesti.

Xhevdet Neziraj, përmendi disa raste të disa shoqatave dhe institucione ndërkombëtare të cilat kanë dhënë disa informacione të gabuara lidhur me komunitetin egjiptas, për gjuhën e tyre. Prandaj kërkoi nga KPM-ja të mos bie nën ndikimin e tyre, dhe të reagoi ndaj këtyre informatave të pavërteta.

Hajdin Abazi, si anëtar i komisionit funksional, i cili ka shqyrtuar raportin, është bërë një debat i nxehtë, sidomos rreth favorizimit të disa rrjeteve, ndërsa disa tjera lihen anash. Lidhur me raportin theksoi se është i përgjithshëm, por duke marrë parasysh problemet buxhetore që është ballafaquar agjensioni, shpresoi se raporti i ardhshëm do të jetë më i detalizuar. Propozoi që në Bordin e Ankesave të jenë pesë veta, në mënyrë që vendimet të merren më lehtë.

Argjentina Grazhdani, deri me nxjerrjen e ligjit të ri për KPM-në, monitorimin e operatorëve e kanë bërë strukturat e UNMIK-ut. Pas miratimit të ligjit kompetencat janë bartur në KPM-në, i cili ka nxjerrur Rregulloren e re që do rregulloj çështjen e licencave. Prandaj është planifikuar që për një vit nga licencat të mblidhen 150.000 € dhe të hyrave nga ato do të shfrytëzohen nga projektet tona. Lidhur me pyetjen e mospasqyrimin në buxhet të të hyrave nga licencat dhe donacionet tjera, arsyeja qëndron në atë se nuk ka pasur të tilla. Të hyrat e vetme kanë qenë mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës. Ndërsa sa i përket shpenzimet të mjeteve posedojmë raportet mujore të cilat tregojnë detalisht shpenzimin e tyre. Lidhur me licencimin e operatorëve kabllorik, janë paraparë disa faza. Në fillim faza e regjistrimit pastaj ajo e licencimit. Duke pasur parasysh faktin se brenda këtyre afateve nuk kanë aplikuar operatorët, për hirë të fleksibilitetit kemi shtyrë atë, ndërsa tani jemi në fazën përfundimtare të rishqyrtimit të këtyre licencave dhe planifikohet që mjetet nga këto të hyra të arkëtohen brenda këtij viti. Lidhur me pyetjen e shkrimeve në gazeta, znj. Grazhdani tha se KPM-ja nuk administron gazetatat. Pranoi faktin se ndaj TV

lokale ekziston një qasje më të butë sa i përket shqiptimit të gjobave. Ndërsa lidhur me rastin e TV Mitrovicës, arsyeja e revokimit të licencës ka qenë shkelja e kushteve të saj dhe veprimi i KPM-së ka qenë konform Ligjit për revokimin e licencës.

Naile Krasniqi, theksoi se ekziston vendimi për pagesë të licencës nga operatorët dhe konform këtij do të licencohen ata. Të gjitha mjetet e arkëtuara nga licencat do të përfshihen në projekt buxhetin e viti 2009. Ndërsa mjetet nga sanksionimi i operatorëve do të shkojnë në buxhetin e Kosovës.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni me nëntë vota PËR dhe një KUNDËR (z. Demaliaj) , nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet në parim Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2007, dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis ne rendin e ditës, për shqyrtim në seancën plenare.

5. Shqyrtimi i Raportit të detalizuar financiar të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për vitin 2007

Kryesuesi, njoftoi anëtarët se raporti është vonuar me gjithë plotësimet që janë bërë. Megjithatë kërkoi që të miratojnë atë me shpresë që herën tjetër të jetë i kompletuar dhe i paraqitur brenda afatit ligjor.

Haki Shatri, theksoi se posedon informacione që një pjesë e të hyrave të RTK-së janë pasqyruar në raport. Si Komision nuk kemi kompetencë të diskutojmë ato informacione të paargumentuara. Megjithatë u pajtua që të përkrahet ai, ndërsa të lehet mundësia e trajtimit të këtij raporti, pas marrjes së raportit të Auditorit Gjeneral për RTK-në.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Zëvendëskryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet në parim Raporti i detalizuar financiar i RTK-së për vitin 2007, dhe rekomandohet Kryesisë së Kuvendit që të njëjtin ta radhis ne rendin e ditës, për shqyrtim në seancën plenare.
- II. Pas shqyrtimit, Komisioni konstatoi se i njëjti nuk i përmbush standardet e raportimit gjithëpërfshirës financiar dhe si i tillë nuk përmban finalizimin e pjesës financiare me sqarime të paragrafëve tabelare, në pajtim me nenin 46 dhe procedurën e përcaktuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
- III. I rekomandohet Kuvendit, që me shkrim t'i drejtohet Auditorit Gjeneral të Kosovës, më këtë kërkesë që të bëjë auditimin e rregullatives financiare që përfshinë kontrollimin dhe vlerësimin e arkivit financiar dhe evidencave tjera financiare, dhe të paraqes raportin me mendime për çështjet që kanë të bëjnë me auditimin, në pajtim me nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 3.1, 3.2, 3.3(a)1 3.6 dhe 3.7 të Ligjit nr.L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit Kryesorë të Kosovës dhe Zyrës së Auditorit të Kosovës.

6. Të ndryshme

Kryesuesi, prezantoi planin gjashtë mujor të punës së Komisionit (korrik-dhjetor 2008), i cili mund të plotësohet dhe ndryshohet varësisht nga aktivitetet që ka Komisioni. Gjithashtu njoftoi anëtarët se në takimin në mes kryetareve të komisioneve me kryeparlamentarin është vendosur që komisionet të hartojnë raporte mujor për aktivitete që ka zhvilluar komisioni brenda muajit.

Safete Hadërgjonaj, kërkoi që të përkrahet plani punës i cili është vazhdimësi i planit vjetor. Ndërsa sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i tij.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

Miratohet plani gjashtë mujor (korrik-dhjetor 2008) i punës, me mundësi të plotësimit dhe ndryshimit të tij, varësisht nga aktivitetet prioritare që ka Komisioni.

Armend Zemaj, njoftoi anëtarët se grupi punues për monitorimin e Ligjit të Auditimit të Brendshëm është në përfundim të vizitave të parapara (ka mbetur edhe një në KEK), janë përpiluar raportet për çdo vizitë, dhe së shpejti do të përgatit raportin final, i cili do të diskutohet dhe votohet në Komision dhe Kuvend. Gjithashtu z. Zemaj njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi punues për shqyrtimin e P/L për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka zhvilluar të enjten një takim me ekspertin e USAID-it i angazhuar në këtë projektligj dhe me përfaqësuesit e Administratës Tatimore dhe pas diskutimeve të frytshme, është akorduar që të vazhdojnë takimet e tilla. Në këtë drejtim propozoj që gjatë këtij muaji të organizohet një dëgjim publik, në të cilën do të ftohen grupet e interesit për të dhënë vërejtje dhe propozimet e tyre për këtë projektligj.

Safete Hadërgjonaj, u pajtua që të organizohet një dëgjim publik, në mënyrë që puna në miratimin e këtij projektligji të jetë më transparente dhe të merren parasysh propozimet dhe opinionet të atyre grupeve të interesit që më së shumti i prek ky projektligj.

Kryesuesi, ndau mendimin që të organizohet dëgjimi publik dhe të ftohe grupet e interesit dhe institucionet relevante në këtë drejtim.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin të bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

Me qëllim të analizimit dhe plotësimit eventual të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe puna e komisionit të jetë transparente, Komisioni vendos që të organizoj një dëgjim publik, në të cilin do të ftohen të gjitha grupet e interesit për të dhënë mendimet dhe propozimet e tyre lidhur me këtë projektligj.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani KOCI